VENDIM
Nr.33, datë 15.7.2010

PËR MIRATIMIN E TARIFAVE TË UJIT PËR KONSUM PUBLIK PËR UJËSJELLËS KANALIZIME SHA DURRËS

Në mbështetje të nenit 14 dhe 21 të ligjit nr.8102, datë 28.3.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", të ndryshuar, si dhe metodikës "Mbi vendosjen e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura" në zbatim të këtij ligji, Komisioni Kombëtar Rregullator i ERRU-së

VENDOSI:

1. Të miratojë tarifat e ujit për konsum publik për Ujësjellës Kanalizime sh.a. Durrës, si më poshtë:

	Për ujin e pijshëm	Për ujërat e ndotura
Konsumatorë familjarë:	45 lekë/m^3	12 lekë/m^3
Institucione buxhetore:	90 lekë/m^3	15 lekë/m^3
Ente private:	110 lekë/m^3	15 lekë/m^3
Shitje uji me shumicë		
Komuna Manëz	24 lekë/m^3	
Komuna Sukth	26 lekë/m^3	
Komuna Ishëm	26 lekë/m^3	

Tarifë fikse shërbimi 100 lekë/muaj/klient.

2. Pagesa rregullatore do të jetë 1% e të ardhurave vjetore të llogaritura.

3. Ky vendim hyn në fuqi më 1.7.2010 dhe është i vlefshëm deri në miratimin e tarifave të reja.

KRYETARI
Avni Dervishi